

VENDIM

Nr. 07 datë 29.08.2025

PËR

MIRATIMIN E PROJEKT-PROPOZIMIT PËR FINANCIMIN E QENDRËS
TERAPEUTIKE TË TRAJTIMIT TË FËMIJËVE NË KËSHILLIN E QARKUT PËR
VITIN 2026

Këshilli i Qarkut, i mbledhur sot më datën 29.08.2025, bazuar në Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 "Per vetëqeverisjen vendore", Neni 77/ç; në Ligjin nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Neni 30, në VKM nr. 563, datë 12.8.2005 "Për përcaktimin e përgjegjësisë të qarkut për shpërndarjen e përkujdesjes shoqërore", si dhe në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe MPSSHB nr. 1, datë 02.02.2007 "Mbi zbatimin e VKM nr. 563, datë 12.08.2005",

VENDOSI:

1. Të miratojë projekt-propozimin me titull "Qendër Terapeutike për zhvillimin e fëmijëve, domosdoshmëri për trajtimin neurobiologjik, komunikimin e dëmtuar, marrëdhënien sociale dhe përmirësimin e sjelljes tek fëmijët", për financim në vitin 2026.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Financës dhe Zhvillimit Rajonal dhe Sektori i Kulturës, Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Juridik.

Ky vendim u shpall sot më datë 01.09.2025 dhe hyn në fuqi menjëherë.

